

KONTRATË NËNSHKRIMI AKSIONESH

Ndërmjet

BANKA CREDINS SH.A

dhe

PIRO MILO

Data *23/12*/2020

KONTRATË NËNSHKRIMI AKSIONESH

Vendosur sot, më datë 23/12/2020 midis palëve:

BANKA CREDINS" SH.A., një shoqëri aksionare e organizuar dhe që vepron në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë, e regjistruar pranë Regjistrat Tregtar shqiptar me vendimin nr. 28969 datë 31.01.2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, që vepron si Bankë e nivelit të dytë në Shqipëri, në përputhje me Licencën e Aktivitetit Bankar nr. 16, datë 31.03.2003, lëshuar nga Banka e Shqipërisë, që përfaqësohet nga Drejtori i Përgjithshëm i saj, **Z. Maltin KORKUTI**, lindur më 17.01.1967, me kartë identiteti me Nr. Personal G70117149A madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar. ("Banka");

dhe

Z. Piro MILO, i biri i Vasilit, lindur në Durrës, më 18.08.1967, identifikuar me letër njoftimin me nr. Personal G70818125M, madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar ("Aksionari")

DUKE PASUR PARASYSH QË:

- (A) Shoqëria «BANKA CREDINS» SH.A., është një shoqëri anonime e krijuar e që vepron si person juridik në bazë të ligjeve shqiptare, me Vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Nr. 28969, datë 31.01.2003, e regjistruar në Organet Tatimore me Kodin Fiskal Nr. 3709529, NIPT K316088010, si dhe me licencën Nr.16, datë 31.03.2003 të lëshuar nga Banka e Shqipërisë.
- (B) Aksionarët e Bankës me anë të vendimit Nr. 04/3, të datës 01.10.2019, kanë vendosur të rrisin kapitalin e Bankës në vlerën 24.000.000 euro (njëzet e katër milion euro) nëpërmjet emetimit të aksioneve të reja. Në total numri i aksioneve që emetohen është 14.397.121 (katërmëdhjetë milion e treqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e njëqind e njëzet e një) aksione të reja me book value për aksion 1.667 euro/aksion e konvertuar me kursin e ditës së vendimit.
- (C) Me Vendimin nr.03/1, datë 16.06.2020 të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë "Banka Credins" sh.a është vendosur të shtyhet afati i nënshkrimit të aksioneve të reja ende të panënshkruara, të emetuara me vendimin Nr. 04/3, të datës 01.10.2019. Aktualisht, nga totali i aksioneve të reja të emetuara prej 14.397.121 (katërmëdhjetë milion e treqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e njëqind e njëzet e një) aksione të reja me një vlerë kontabël neto 1.667 euro/aksion janë nënshkruar 3.219.802 (tre milion e dyqind e nëntëdhjetë mijë e teteqind e dy) aksione të cilat janë paguar totalisht dhe mbeten ende të panënshkruara 11.177.318 (njëmbëdhjetë milion e njëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e treqind e tetëmbëdhjetë) aksione të reja të emetuara.
- (D) Në zbatim të kushteve të kësaj Kontrate, Nënshkruesi i Aksioneve ka rënë dakord që të blejë aksione nga aksionet e reja të emetuara duke nënshkruar 87.300

(tetëdhjetë e shtatë mijë e treqind) aksione të reja të zakonshme ("Aksionet"), për një çmim total prej 17.775.153 Lekë (shtatëmbëdhjetë milion e shtatëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e njëqind e pesëdhjetë e tre Lekë), për një çmim prej 1.667 euro/aksion (që i përgjigjet kundërvlerës së çmimit në lekë 203.61 lekë/aksion).

PËR RRJEDHOJË, palët e kësaj kontrate bien dakord si vijon:

1. Përshkrimet; përkufizimet; interpretimet

1.1 Të gjitha përshkrimet e mëparshme të përmbajtura këtu janë pjesë përbërëse dhe konkrete e kësaj Kontrate.

1.2 Gjinia dhe Numri. Çfarëdolloj referimi i bërë në këtë Kontratë mbi gjininë, do të përfshijë të gjitha gjinitë, si dhe fjalët që nënkuptojnë njëjës do të përfshijnë shumësin, dhe e kundërta, përveçse kur përcaktohet ndryshe.

1.3 Titujt, etj., ndarja e kësaj Kontrate në Seksione, nënseksione, klauzola dhe nënndarje të tjera si dhe përfshirja e titujve shërbejnë vetëm për lehtësi referimi dhe nuk duhet të ndikojnë apo përdoren në përpilimin apo interpretimin e kësaj Kontrate.

2 Qëllimi i Kontratës

2.1 Në përputhje me kushtet e kësaj Kontrate, Nënshkruesi i Aksioneve nënshkruan Aksionet.

2.2 17.775.153 Lekë (shtatëmbëdhjetë milion e shtatëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e njëqind e pesëdhjetë e tre Lekë), është ("**Çmimi i Nënshkrimit**").

2.3 Palët bien dakord se Nënshkruesi i Aksioneve do t'i paguajë Çmimin e Nënshkrimit Bankës si më poshtë:

2.4 Shuma prej 17.775.153 Lekë (shtatëmbëdhjetë milion e shtatëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e njëqind e pesëdhjetë e tre Lekë), do të paguhet nga Nënshkruesi i Aksioneve në llogarinë e Bankës pas nënshkrimit të kontratës, duke zbatuar Vendimin e Asamblese se Bankes Credins, Statutin e Bankës dhe Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar.

3. Deklaratat dhe Garancitë

Banka deklaron dhe garanton si vijon:

3.1 Ekzekutimi i Duhur; Zbatueshmëria; Kjo Kontratë është zbatuar në mënyrën e duhur nga Banka dhe kjo Kontratë është e vlefshme dhe detyruese për Bankën, e zbatueshme në përputhje me parashikimet e saj.

3.2 Përputhshmëria. Lidhja e kësaj Kontrate, dhe përshtatja me kushtet e përcaktuara në të nuk bien në kundërshtim apo përfundojnë në shkelje të ndonjë dispozite, ose të kërkojnë ndonjë aprovim mbi të, ose të rezultojnë në vendosjen e ndonjë barre, ndonjë kontratë apo instrument tek e cila Banka është pjesë, apo me anë të së cilës Banka apo ndonjë prej aseteve të tij lidhen, si dhe nuk do të përbëjë shkelje apo ndodhi e cila me njoftimin, kalimin e kohës apo marrjen e ndonjë vendimi, apo ndonjë kombinimi midis të lartpërmendurave të përbëjë ndonjë shkelje të këtyre lloj kontratave apo instrumenteve.

3.3 Zotërimi i Aksioneve, të pangarkuara me barrë. Me lidhjen e kësaj kontrate dhe pagesën e Çmimit të Nënshkrimit, Aksionari bëhet zotërues ligjor dhe përfitues i Aksioneve të Reja, të lira nga çfarëdolloj barre dhe/ose detyrimi të mundshëm, dhe

Banka ka të drejtën t'i japë titullin e plotë ligjor mbi Aksionet Aksionarit, sipas kushteve të përcaktuara në këtë Kontratë.

4. Të ndryshme

4.1 Njoftime. Çdo njoftim, aplikim, apo komunikim tjetër që duhet dhënë apo kryer në zbatim të kësaj Marrëveshje për Aksionarin apo Bankën do të jetë me shkrim. Përveçse kur parashikohet ndryshe nga kjo Kontratë, ky njoftim, kërkesë apo tjetër lloj komunikimi do të konsiderohet si e dhënë apo marrë në mënyrën e duhur, kur dorëzohet dorazi, në vijë ajrore, me email apo faks tek pala të cilës i drejtohet, lejohet të jepet, apo kryhet tek adresa e kësaj pale siç përcaktohet me poshtë, ose tek adresat e tjera, sipas përcaktimeve të kësaj pale kundrejt palës të cilës i drejtohet ky njoftim, aplikim apo tjetër lloj komunikimi.

Për Bankën: Rr. Vaso Pasha, Nr. 8, Tiranë, Shqipëri.

Për Nënshkruesin e Aksioneve:

Rr. Qemal Stafa, Pall.132, Ap.13, Kodi Postar 1017, Tiranë, Shqipëri.

4.2 Ligji i zbatueshëm dhe Juridiksioni. Kjo Kontratë do t'i nënshtrohet dhe interpretohet në përputhje me ligjin shqiptar. Çdo lloj mosmarrëveshje, kundërshti apo pretendim i dalë, në lidhje me këtë Kontratë, si dhe çdo shkelje, përfundim, apo pavlefshmëri do t'i nënshtrohet shqyrtimit të gjykatave shqiptare.

4.3 Gjuha. Kjo Kontratë është lidhur në 4 (katër) kopje me vlerë të njëjtë në gjuhën shqipe.

PËR SA MË SIPËR, palët e kësaj kontrate duke vepruar personalisht apo nëpërmjet përfaqësuesve të tyre të autorizuar sipas ligjit, kanë lidhur këtë Kontratë, e cila duhet nënshkruar në emrin e tyre, në datën e shënuar më sipër.

BANKA

Nënshkruar nga **Z. Maltin KORKUTI**
për llogari të
"BANKA CREDINS" SH.A

Nënshkruesi i aksioneve

Z. Piro MILO

Piromilo





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË

DEGA VENDORE TIRANË

NOTER JULIAN ZHELEGU
ADRESA Njesia Bashkiake nr. 5, Rr.
Pjeter Bogdani, Godina Nr. 13, Hyrja Nr.
2
TEL: 0682027818

VËRTETIM I NJËSISË ME ORIGINALIN

Nr. repertori: 8262

Tirane më 23/12/2020

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"



V2020053950436867289



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË
NOTER JULIAN ZHELEGU**



**DATE 23/12/2020
NR REP 8262**

VËRTETIM NJËSIE ME ORIGINALIN

Sot, më datë 23/12/2020, para meje Noterit JULIAN ZHELEGU, Anëtar në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Njesia Bashkiake nr. 5, Rr. Pjeter Bogdani, Godina Nr. 13, Hyrja Nr. 2, u paraqit personalisht:

KËRKUESE:

Zhaneta Bedaj, atësia Abas, amësia Xhevrije, shtetase Shqiptare, lindur në Elbasan dhe banues në TIRANË, me adresë Nikolla Jorga; Nd. 9; H. 4; Ap. 27; Njësia Administrative Nr. 7; Njësia Bashkiake Nr. 7; 1023; Tiranë, lindur më 01/05/1977, gjendja civile "e martuar", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 033866449 dhe nr. personal H75501236Q;

e cila me kerkoi te vertetoj dokumentin bashkelidhur: **Kontrate tip e anetaresimit me nr. serial 0000006267.**

Unë Noteri, pasi i bëra të qartë personit të mësipërm, përgjegjësinë penale në rast paraqitje të dokumenti të rremë; bëra krahasimin e përmbajtjes së dokumentit origjinal me fotokopjen e paraqitur, mbi të cilat më rezultoi se nuk janë bërë korrigjime, shtesa, fshirje, a shenja të tjera të dyshimta.

Si rrjedhim, në bazë të nenit 62, shkronja "i", nenit 129 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë"; Vërtetoj se fotokopja e dokumentit të paraqitur nga kërkuesi para meje Noterit, është e njëjtë me dokumentin origjinal. Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noteri deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të kërkuesit të këtij dokumenti, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

**NOTER
JULIAN ZHELEGU**





**CREDINS
INVEST**

Ref no: 0000006267

**KONTRATË TIP E ANËTARËSIMIT
NË FONDIN E INVESTIMIT
"Credins Premium"**

TË DHËNAT E INVESTITORIT TË FONDIT

Emër Atesia Mbiemër Piro Vasil Milo Rrjetësia Shqiptari
Nr personal 070818125M (bashkëlidhur kopje e dok të identifikimit),
Data e lëshimit: 24/10/2019, Data e skadimit: 23/10/2029 Shteti ku paguan taksat: Shqiptari
Datelindja 18/08/1967, Vendlindja Durrës Adresa Vendbanimit Rruga Qemal Stafa, Pll 132, Ap.13, Tirane
Kodi Postar 1000 Adresa korrespondencës: Rruga Qemal Stafa, Pll 132, Ap.13, Tirane
Kodi Postar 1000 Tel/Cel 0697072601 E-mail piro.milo@bankacredins.com Nr. i Pasaportës
(vetëm për shlefatë e huaj)
Nr i lejes së qëndrimit në Shqipëri, _____ (kopje e të cilës i bashkëlidhet kontratës)
Nr NJIS _____ vetëm për personat tregtar të regjistruar juridik apo person fizik
Daten e vendimit të regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB), _____
(bashkëlidhur fotokopje të dokumentit që vërteton objektin e veprimtarisë).

Nën cilësimin e ANËTARIT të Fondit të investimit "Credins Premium", deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë ligjore se jam informuar, kam kuptuar dhe jam dakord me përmbajtjen e kushteve të kontratës, PROSPEKTIN, si dhe larifat e aplikuar nga Credins Invest sh.a. - Shoqëria Administruuese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive

TË DHËNAT E SHOQËRISË ADMINISTRUESE

CREDINS INVEST sh.a. - Shoqëria Administruuese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive është shoqëri e krijuar në përputhje me kadrin ligjor shqiptar dhe është regjistruar si person juridik me Vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë, nr.34260, datë 31/10/2005, rritësuar nga Autoriteti i Mbikëqytjes Financiare me Vendimin nr.85, datë 30/05/2016, me seli në adresën: Rr "Nikolla Tupë" Nr.1, Kat 2, Tiranë, përfaqësuar nga znj. Estela KOCI, Administrator i Përgjithshëm.

Shuma e investuar 17,800,000.00 Lekë mënyra e pagesës Transferite

Nr. Llogaritë së Depozitarit AL98 2101 1012 0000 0000 0166 7197

(Barimi i të ardhurave Kursime dhe depozita në banke)

I punësuar në Banka Credins Pozicioni i punës: Përgjegjës i Sektorit të Mirëmbajtjes

Mënyra e Investimit:

☒ Pagesë e Menjëhershme,

☐ Plan Investimi. Frekuenca e zgjedhur e pagesave

☐ Mujore,

☐ Tremujor,

☐ Semi-vit,

☐ Në vit

Investitorët në Fond janë të këshilluar që të qëndrojnë të paktën 2 vite nga investimi fillestar për shkak të veçorisë të aseteve të Fondit. Nëse keni një plan më të shkurtër investimi, ju lutem specifikoni kohëzgjatjen e parashikuar në fond.

Kohëzgjatja e parashikuar e investimit (në muaj):

Nën cilësimin e përfaqësuesit ligjor të CREDINS INVEST sh.a, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë ligjore se investimi i kontributeve, do të shërbejë vetëm për qëllime të ligjshme dhe njëkohësisht burimi i tyre është nga një aktivitet i ligjshëm.

Data e lidhjes së kontratës 03/12/2020

Vendi Tirane

ANËTARI

Shoqëria Administruuese Credins Invest sh.a.
përfaqësuar nga

Neni 1 OBJEKT

- Objekt i kësaj kontrate është të rregullohet marrëdhëniet kontraktuale ndërmjet Anëtarit të Fondit të investimit dhe Credins Invest sh.a. Shqëri Administruese e Fondëve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive (këtu në vijim "Shoqëria Administruese").
- Marrëdhëniet kontraktuale të dyshimit, të përmendura në pikën 1, rrjedhin nga anëtarësimi në Fondin e investimit "Credins Premium" (këtu në vijim "Fondi"), me qëllim investimin e aseteve dhe ofrimin e përfuturave të:
 - investitorit prej akumulimit të vlerës së këtyre kuotave
 - mbajtësit e kuotave (këtu e në vijim "Anëtar") si shpërndarje periodike e ardhur nga investimi i vlerës së këtyre kuotave.

Neni 2 SUBJEKTET E KONTRATËS

- Subjekte të kësaj kontrate janë individët, i cili gëzon zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, shtetas shqiptar apo i huaj, i cili me pëlqimin e vet bëhet anëtar i Fondit, si dhe Shoqëria Administruese, e cila në respektim të kontratës dhe të legjislacionit në fuqi ofron shërbimet e fondit të investimit, nëpërmjet kuotave në një fond investimi.
- Subjektet e kësaj kontrate janë çdo person fizik ose juridik, i cili me pëlqimin e vet bëhet anëtar i Fondit, (mbajtës kuotash) si dhe Shoqëria Administruese, e cila në respektim të kontratës dhe të legjislacionit në fuqi ofron shërbimet e fondit të investimit, nëpërmjet kuotave në një fond investimi.

Neni 3 BAZA LIGJORE

Kjo kontratë hartohet në përputhje të plotë me kuadrin ligjor në fuqi, si Kodin Civil, ligjin nr.10198, datë 10.12.2009 "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive", me aktet nënligjore të dala në zbatim të tij, si dhe rregulloret e brendshme të Shoqërisë Administruese.

Neni 4 PËRKUFIZIME

Termat e përdorur në këtë Kontratë kanë kuptimin e dhënë në ligjin nr.10198, datë 10.12.2009 "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive", dhe në prospektin bashkëlidhur kësaj kontrate.

Neni 5 ANËTARËSIMI NË FOND

- Mund të anëtarësohet në këtë Fond çdo individ; person fizik apo juridik, i cili me pëlqimin e tij bëhet anëtar i fondit të investimit dhe lidh këtë kontratë anëtarësimi me Shoqërinë Administruese për të përfutur shërbimet e fondit të investimit.
- Është pjesë përbërëse e kësaj kontrate formulari standart i aplikimit, i cili përmban deklaratën e anëtarit Duke e nënshkruar këtë deklaratë anëtar, pranon kushtet e kontratës, si dhe deklaron nën përgjegjësinë e tij se është njohur dhe ka kuptuar plotësisht prospektin e Shoqërisë Administruese.

Neni 6 VLERA FILLESTARE E KUOTËS

- Kuota e anëtarit në këtë fond investimi, do të jenë aset i tij në fond dhe do të jenë të anëtarit në monedhën lekë. Shuma minimale e investimit në kuotë do të jetë jo më pak 2,000 (dy mijë) lekë. Çmimi i blerjes së kuotës do të jetë çmimi i zbatueshëm në ditën e kryerjes së pagesës në fond, llogaritur në përputhje me ligjin nr.10198, datë 10.12.2009, aktet nënligjore të dala në zbatim të tij, si dhe prospektin e fondit të investimit Credins Premium.
- Procedura e blerjes së kuotave nga Anëtar, përcaktohet në prospektin e Shoqërisë Administruese, i cili është pjesë përbërëse e kësaj kontrate. Blerja e kuotave nëpërmjet një oferte publike kryhet vetëm nëpërmjet pagesës së aseteve monetare ku blerësi (mbajtës kuotash); sipas kësaj kontrate pas blerjes së kuotave, ka përcaktuar detyrimet kontraktuale me Shoqërinë Administruese. Shoqëria Administruese sipas përcaktimeve të kësaj kontrate, ligjit, akteve nënligjore të dala në zbatim të tij është e detyruar të administrojë asetet e paguara; si pjesë të aseteve kolektive, në përputhje me kushtet dhe kriteret e treguara në prospekt. Blerja e kuotave nga blerësi (mbajtës kuotash); mund të kryhet edhe duke shpërndarë kuotë të reja në bazë të shpërndarjes së pjesës në fitim, domethënë kur vlera e kuotave zvogëlohet në bazë të dhënës së kuotave të reja, ose në çdo rast tjetër, të parashikuar nga ligji aktet nënligjore të dala në zbatim të tij, si dhe rregulloret që miraton autoriteti mbikëqyrës (AME). Mbajtësit e kuotave janë përgjegjës për detyrimet e fondit të investimit deri në shumën e pjesëmarrjes së tyre në fond.

Neni 7 POLITIKA E INVESTIMIT

- Investimi i aseteve të Fondit synon optimizimin e kthimit nga investimi duke minimizuar risikun, me qëllimin për t'u siguruar anëtarëve të Fondit përfitime të larta nga investimi i kuotave.
- Karakteristikat e Fondit dhe të politikës së investimeve janë paraqitur në prospektin e bashkëlidhur kësaj kontrate.
- Anëtar (mbajtës kuotash), pasi bie dakord me këtë kontratë dhe prospektin, merr përsipër risikun e investimit të Fondit. Çmimi i një kuote dhe e ardhura nga investimi mund të ulët apo të rritet dhe nuk ka garanci për një normë kthimi të paracaktuar.
- Shuma e akumuluar në Fond nuk është e garantuar nga Agjencia e Sigurimit të Depozitave (ASD).

Neni 8 DEPOZITARI

- Shoqëria Administruese, ka lidhur një kontratë me Banka Amerikane e Investimeve sh.a. me seli në adresën Rruga e Kavajës, Ndërtesa 27, Hyrja 1, Njësia Bashkiqe Nr.10, Kodi Postar 1001, Tiranë, e cila në përputhje me ligjin nr. 10198, datë 10.12.2009 "Për fondet e investimeve kolektive", do të ofrojë shërbimet e Depozitarit për asetet e Fondit.
- Depozitari në këtë kontratë, nënkupton bankën e licencuar nga Banka e Shqipërisë, për të ofruar shërbime kujdestarie, depozitimi dhe të besimit. Depozitari gëzon cilësinë e entitetit tërësishëm të pavarur nga Shoqëria Administruese dhe çdo palë tjetër të lidhur me të. Depozitari siguron që të gjitha të ardhurat e fondit të investimit do të shpërndahen në përputhje me Ligjin dhe kontratën.
- Depozitari do të jetë përgjegjës për ruajtjen e Aseteve të fondit të investimit dhe të aseteve të anëtarëve në Fond.
- Depozitari kontrollon administrimin e aseteve të Fondit nga Shoqëria Administruese, në përputhje me dispozitat e kontratës, prospektit, si dhe të legjislacionit në fuqi.
- Depozitari siguron që në transaksionet që përfshijnë asetet e fondit të investimit, t'i kthehet fondit të investimit çdo përfitim brenda afateve kohore të përcaktuara.

Neni 9 MBROJTJA E ASETEVE TË FONDIT TË INVESTIMIT

Asetet e fondit të investimit, të depozituara në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi, nuk mund t'u nënshtrohen ekzekutimeve për detyrimet që depozitari ka ndaj të tretëve. Asetet e fondit të investimit duhet të veçohen nga asetet e depozitarit, në bazë të së drejtës së veçimit në procedurë falimentare dhe nuk përfshihen në shlyerjen e detyrimeve të kreditorëve të depozitarit.

Neni 10 TË DREJTAT DHE DETYRIMET E SHOQËRISË ADMINISTRUESE

Shoqëria Administruese në kuadër të kësaj kontrate ka detyrën kontraktuale:

- Të administrojë me efektivitet asetet e anëtarëve në fond, nëpërmjet diversifikimit të investimeve, me synim rritjen e aseteve të anëtarëve.
- Të ofrojë përfitime nga investimi dhe përfitime të tjera (këtu nënkuptohen përfitimet e parashikuara me nenin 116 dhe 118 i ligjit nr.10198, datë 10.12.2009), tek anëtarë, sipas kushteve dhe procedurave ligjore.
- Të informojë çdo anëtar lidhur me prospektin e Shoqërisë Administruese përpara se të nënshkruajë kontratën.
- Shoqëria Administruese do të mundësojë pajisjen e anëtarëve me emër përdoruesi dhe fjalëkalim, për të kontrolluar transaksionet, gjendenj në Fond dhe informacione të tjera nëpërmjet Web-it.
- Të respektojë konfidencialitetin e llogarive individuale të çdo Anëtarit dhe të japë informacion mbi asetet vetëm tek Anëtarët e Fondit, personat e autorizuar nga Anëtarit, si dhe në rastet e tjera të parashikuara nga Ligji.
- Të informojë në çdo kohë Anëtarët për sa i përket ndryshimeve në politikat e investimit, si dhe rregulloret përkatëse që krijojnë efekte për Anëtarët.
- Të kryejë këmbimin e aseteve, mbështetur në kërkesën me shkrim të Anëtarit, në një Fond tjetër të menaxhuar nga e njëjta Shoqëri Administruese.
- Të kryejë pagesën e menjëhershme të vlerës neto të aseteve në llogarinë e mbajtësit të kuotave apo investitorit që i përgjigjen kësaj vlerë, mbështetur në kërkesën me shkrim të Anëtarit, sipas kontratës.

Neni 11 GARANCITË

Shoqëria Administruese garanton, që do të zbatojë legjislacionin në fuqi dhe:

- asetet e fondit të investimit nuk do mund të jenë objekt i pretendimeve ose ekzekutimeve, të kryera në emër dhe për llogari të kreditorëve të shoqërisë administruese.
- Fondi i investimit nuk mund të jetë pjesë e procedurës së falimentimit.

Neni 12 TË DREJTAT DHE DETYRIMET E ANËTARIT

Anëtarit i fondit të investimit, sipas kësaj kontrate, ka të drejtat dhe detyrimet e mëposhtme:

- Të ketë pronësinë e aseteve të investuara në Fond;
- Të posedojë certifikatën e blerjes së kuotave të fondit jo më vonë se 7 ditë kalendrike nga data e pagesës së bërë në fond sipas kushteve dhe procedurave ligjore;
- Të këmbtojë kuotat e veta me kuotë në një fond tjetër të administruar nga e njëjta shoqëri administruese, sipas zgjedhjes së tij;
- Të përfitojë paratë e kuotave të shlyera të fondit jo më vonë se 7 ditë kalendrike nga data e marrjes së një kërkesë të vlefshme sipas kushteve dhe procedurave ligjore.

Neni 13 PAGESA E PËRFITIMEVE

- Anëtarit i fondit të investimit, sipas zgjedhjes, ka të drejtë të marrë pagesën e menjëhershme të vlerës neto të aseteve në llogarinë e tij sipas përcaktimeve të bëra në nenet 114, 115, 116, 117 të ligjit ligjin nr. 10198, datë 10.12.2009 "Për fondet e investimeve kolektive".
- Pagesa e vlerës së kuotave, do të kryhet në bazë të kërkesës me shkrim të Anëtarit, në llogarinë e tij, jo më vonë se 7 ditë nga marrja e kërkesës.

Neni 14 SHLYERJA E KUOTAVE TË FONDIT TË INVESTIMIT

Anëtarit i Fondit, sipas zgjedhjes, ka të drejtë që të kërkojë shlyerje të kuotave të investimit sipas çmimit të zbatueshëm në bazë të prospektit të Fondit të investimit dhe rregulloret të asgjera nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, në kohën e marrjes së kërkesës së vlefshme për shlyerje.

Neni 15 PAGESA E ASETEVE NË RASTIN E VDEKJES SË ANËTARIT

Në rastin kur Anëtarit vdes përpara se të marrë pagesën e të gjithë kuotave/aseteve të veta, kuotat në llogarinë e tij/saj u shpërndahen trashëgimtarëve në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, që rregullojnë trashëgiminë.

Neni 16 TARIFA E SHOQËRISË ADMINISTRUESE

Shoqëria Administruese në emër dhe për llogari të këtij Fondi do të aplikojë tarifën e mëposhtme:

- Tarifa e administrimit të Fondit do të jetë 1 % në vit e vlerës neto të aseteve të Fondit. Vlera neto e aseteve përbëhet nga vlera e përgjithshme e aseteve e zvogëluar nga zbritja e detyrimeve dhe tarifave deri në datën e vlerësimit.
- Tarifa e administrimit të Fondit do t'i ngarkohet aseteve të Fondit në fund të çdo dite, dhe do të mbahet në fund të çdo muaji, si shumë e vlerës ditore për atë muaj.
- Çdo ndryshim i tarifave që do të aplikohen nga Shoqëria Administruese, do t'u njoftohet Anëtarëve të Fondit, të paktën 2 muaj përpara.

Neni 17 KOHËZGJATJA E KONTRATËS

1. Kjo kontratë lidhet për një afat të pacaktuar, dhe do të sjellë pasojë ligjore vetëm pasi, të jetë kryer pagesa e parë e kuotës në fondin e investimit, sipas metodës së rënë dakord mes palëve.

2. Kontrata e fondit të investimit, do të përfundojë:

- Në rastin kur të gjitha asetet e Anëtarit të fondit janë transferuar në një tjetër Fond investimi;
- Në rastin e shlyerjes së kuotave të Anëtarit të Fondit;
- Në rastin e vdekjes së Anëtarit të Fondit.

Neni 18 GJYKATA KOMPETENTE

Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis palëve të kësaj kontrate do të zgjidhet me mirëkuptim. Nëse nuk arrihet mirëkuptimi mes palëve, ato gëzojnë të drejtën t'i adresohen për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve Gjykatës së Rrethit, Tiranë.

Neni 19 DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

- Në të gjitha rastet që kërkojnë nga ligji, ndryshimet dhe shtesat në kontratë do të marrin miratimin e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare. Ndryshimet dhe shtesat në kontratë do të bëhen me mirëkuptimin e palëve nënshkruese të saj.
- Kjo kontratë hartohet në gjuhën shqipe në tre kopje identike.

BANKA CREDINS SH.A.

NIPT; K316088010

Gjendja e aksioneve dhe vlera e kapitalit dt.24.12.2020

Nr.re ndor	Aksioneret e Bankes	Gjendja e aksioneve dhe vlera e kapitalit 13.10.2020				Blerje aksionesh te reja sipas kontrates se blerjes nga Piro Milo				Gjendja e aksioneve dhe vlera e kapitalit 24.12.2020			
		%	nr.aksione	Vlera ne leke	nr.aksione	Vlera ne leke	%	nr.aksione	Vlera ne leke	%	nr.aksione	Vlera ne leke	
1	Renis Tershana	18.543%	17,250,559.00	1,866,683,313.17			18.525%	17,250,559.00	1,866,683,313.17				
2	Aleksander Pilo	8.730%	8,121,616.00	879,795,730.49			8.722%	8,121,616.00	879,795,730.49				
3	BESE Holding	15.223%	14,162,029.00	1,532,540,757.28			15.208%	14,162,029.00	1,532,540,757.28				
4	Unioni Shqiptar Kursim Kredite	2.526%	2,350,358.00	254,343,454.90			2.524%	2,350,358.00	254,343,454.90				
5	Monika Milo	4.307%	4,007,273.00	433,646,152.43			4.303%	4,007,273.00	433,646,152.43				
6	Fuad Haxhiymeri	2.943%	2,738,347.00	296,329,596.44			2.941%	2,738,347.00	296,329,596.44				
7	Maitin Korkuti	2.629%	2,446,171.00	264,711,850.54			2.627%	2,446,171.00	264,711,850.54				
8	Jorgjia Balli	0.483%	448,899.00	48,577,521.58			0.482%	448,899.00	48,577,521.58				
9	Leonat Koço	0.365%	339,358.00	36,723,543.92			0.364%	339,358.00	36,723,543.92				
10	Neritan Dojaka	0.521%	484,381.00	52,417,189.02			0.520%	484,381.00	52,417,189.02				
11	Gjergj Bushati	0.008%	7,133.00	770,369.04			0.008%	7,133.00	770,369.04				
12	Emi Santo	2.893%	2,691,805.00	291,293,071.89			2.891%	2,691,805.00	291,293,071.89				
13	Egi Santo	2.893%	2,691,805.00	291,293,071.89			2.891%	2,691,805.00	291,293,071.89				
14	Vjollca Bushati	0.164%	152,837.00	16,539,229.64			0.164%	152,837.00	16,539,229.64				
15	Andon Daka	0.710%	660,372.00	71,462,002.36			0.709%	660,372.00	71,462,002.36				
16	Mirela Ndini	0.692%	643,756.00	69,663,907.64			0.691%	643,756.00	69,663,907.64				
17	EDRO	1.279%	1,190,051.00	129,429,453.79			1.278%	1,190,051.00	129,429,453.79				
18	Edmond Rexho	0.301%	279,918.00	30,291,264.78			0.301%	279,918.00	30,291,264.78				
19	Elisbeta Hysi dhe Artur Hysi	2.006%	1,865,972.00	202,494,077.86			2.004%	1,865,972.00	202,494,077.86				
20	Pandeli Garo	0.553%	514,517.00	56,088,657.70			0.553%	514,517.00	56,088,657.70				
21	Veneranda Bushati	0.043%	39,769.00	4,303,588.78			0.043%	39,769.00	4,303,588.78				
22	Aida Bushati	0.043%	39,769.00	4,303,588.78			0.043%	39,769.00	4,303,588.78				
23	Albens Bushati	0.043%	39,769.00	4,303,588.78			0.043%	39,769.00	4,303,588.78				
24	A.F.C SHPK	3.495%	3,251,183.00	358,535,318.81			3.491%	3,251,183.00	358,535,318.81				
25	Astrit Hana	0.714%	664,650.00	71,924,948.85			0.714%	664,650.00	71,924,948.85				

26	Arjan Hana	1.072%	996,975.00	107,887,430.49			1.071%	996,975.00	107,887,430.49
27	Prima shpk	2.935%	2,730,851.00	336,467,479.57			2.933%	2,730,851.00	336,467,479.57
28	Elena Haxhiymeri	1.062%	988,247.00	121,761,676.39			1.061%	988,247.00	121,761,676.39
29	Alba Thomollari	0.118%	110,131.00	13,835,438.67			0.118%	110,131.00	13,835,438.67
30	Tefik Kokona	0.254%	236,059.00	29,655,389.06			0.254%	236,059.00	29,655,389.06
31	Edita Hoxha	0.186%	173,109.00	21,003,726.64			0.186%	173,109.00	21,003,726.64
32	Bardhi Hoxha	0.135%	125,897.00	15,816,143.66			0.135%	125,897.00	15,816,143.66
33	Edmond dhe Merita Hoxha	0.483%	449,199.00	54,086,326.42			0.482%	449,199.00	54,086,326.42
34	Robert Lukaj	0.059%	55,080.00	6,919,547.97			0.059%	55,080.00	6,919,547.97
35	Robert Kasneci	0.951%	884,772.00	107,098,414.81			0.950%	884,772.00	107,098,414.81
36	Lorenc Bejko dhe Maria Gracia	0.255%	236,925.00	28,369,142.48			0.254%	236,925.00	28,369,142.48
37	Helidon KOKONA	0.286%	265,959.00	33,411,636.92			0.286%	265,959.00	33,411,636.92
38	Suela Hoxha	0.135%	125,897.00	15,816,066.97			0.135%	125,897.00	15,816,066.97
39	Drilan Todhe	0.338%	314,744.00	39,540,357.24			0.338%	314,744.00	39,540,357.24
40	Hajrulla Kalo	0.379%	352,930.00	44,337,567.64			0.379%	352,930.00	44,337,567.64
41	Fatmira Dina	0.535%	497,788.00	59,663,661.20			0.535%	497,788.00	59,663,661.20
42	Mira Meksi	0.169%	157,371.00	19,770,070.20			0.169%	157,371.00	19,770,070.20
43	Elvira Baboci	0.254%	236,059.00	29,655,389.06			0.254%	236,059.00	29,655,389.06
44	Amryta Capital LLP	6.453%	6,003,262.00	647,053,200.51			6.447%	6,003,262.00	647,053,200.51
45	Akil Alizoti	0.263%	244,738.00	26,693,869.12			0.263%	244,738.00	26,693,869.12
46	Artur Agolli	0.789%	734,124.00	79,443,058.56			0.788%	734,124.00	79,443,058.56
47	Petrit Kasapi	1.313%	1,221,465.00	131,965,443.43			1.312%	1,221,465.00	131,965,443.43
48	Keti Xhamo	0.284%	263,806.00	28,712,533.39			0.283%	263,806.00	28,712,533.39
49	Shefki Doma	0.917%	853,355.00	94,546,798.06			0.916%	853,355.00	94,546,798.06
50	Ashim Doma	0.917%	853,355.00	94,546,798.06			0.916%	853,355.00	94,546,798.06
51	Aridt Duma	0.542%	503,852.00	54,839,040.06			0.541%	503,852.00	54,839,040.06
52	Frigo Alba	0.676%	629,148.00	70,581,784.43			0.676%	629,148.00	70,581,784.43
53	Tonin Binoshaj	0.101%	94,372.00	10,587,244.83			0.101%	94,372.00	10,587,244.83
54	Xhemal Klosi	0.185%	171,912.00	19,286,169.96			0.185%	171,912.00	19,286,169.96
55	Gezim Balla	0.372%	346,428.00	38,864,474.83			0.372%	346,428.00	38,864,474.83
56	Kujtim Spahiu	0.145%	134,892.00	14,712,456.01			0.145%	134,892.00	14,712,456.01
57	Petraq Pavlo	0.193%	179,964.00	20,172,164.76			0.193%	179,964.00	20,172,164.76
58	Ikbal Pavlo	0.064%	59,988.00	6,724,054.92			0.064%	59,988.00	6,724,054.92
59	Kristina Pilo	4.967%	4,621,184.00	500,602,094.64			4.963%	4,621,184.00	500,602,094.64

Vepirime ne llog. 00001467548

TIRANE, 23.12.2020

Ne favorin tuaj

I NDERJAR Z.
MILO PIRO
VASTIL
RR QEMAL STAFEA NR 132 AP 13
01101 TIRANE TR

NDP W 000154082220 231220 11:18 01

SHUMA O

Urderet: MILO PIRO
RR QEMAL STAFEA NR 132 AP 13
01101 TIRANE TR
KodVepir: 34 Urdereshkrim (midis llog. veta)
Refer.: SA FAKTOR PRIVAT PER BILPUEN E 87300
AKSIONE SIEM KONTRATES
Kursi 1,000000
KUNDERVLERA L 7.989.696,00

TOTALI KREDI: L 7.989.696,00 23.12.2020

CREDINS Bank
Back Office 01
Finance Kontabilitet

Vepirime ne llog. 00001467532

TIRANE, 23.12.2020

Ne favorin tuaj

I NDRUAR Z.
MILO PIRO
VASTIL
RR. GJERAL STAFJA NR 132 AP 13
01101 TIRANE TR

NDP WV 000154082128 231220 11:18 01

SHUMA O

Under: MILO PIRO
RR. GJERAL STAFJA NR 132 AP 13
01101 TIRANE TR
KodVepir: 34 Underzhirrim (michis llog. veta)
Refer.: SA PAQJAR KAPITALI PER BIERJEN E
87300AKSIONE STEPAS KONTRAPATES
Kursi
KUNDERVALERA 1,000000 9.785.457,00

TOTALI KREDI: L 9.785.457,00 23.12.2020

ECREDITINS BANK
Back Office 01
Finance Kontabilitet